

Kontratë Dhurimi

E lidhur në Tiranë sot më datën 25/10/2013 ,midis:

Dhuruesit: Shoqëria “T.A.L.M.” Group Sh.P.K e përfaqshuar nga administrator i saj, z. Hamad Ben Abdennabi, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar me letërnjoftimin Nr.025330478, me Seli “Rr. Sulejman Delvina” Qendra “Zayed” Nr. 8/6 kati 8 Tiranë.

Perfituesi i Dhurimit: z. Ganem Bin Saad Maged Al Saad Al Kuwari me kartë identiteti me Nr. 26463400177, përfaqësuar në këtë kontratë me autorizim të posaçëm model th/2 me Nr. Protokollit 006587 nga z. Hamad Ben Abdennabi me banim ne adresën: Rr. Durresit,P.karavan,U2 ,Nr31

Objekti: Dhurimi (kalimi) i të gjitha kuotave dhe titujve të kapitalit(në masën 100%) të shoqërisë “CIT” Sh.P.K nga pronësia e personit juridik “T.A.L.M” Group me seli në Doha të shtetit të Katarit me pronar(ortak) të vetëm zotin Ganem Bin Saad Maged Al Saad Al Kuwari në pronësi të plotë (në masën 100%) të personit fizik z. Ganem Bin Saad Maged Al Saad Al Kuwari me kartë identiteti me Nr. 26463400177 me banim ne Doha të Katarit.

Baza Ligjore: Neni 761 e vijues te codit civil per kontraten e dhurimit, neni 73 i ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe neni 43 I ligjit 9723 datë 03/05/2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” të shoqërive Tregtare.

Të dy palët ranë dakort si vijon:

Neni 1

Dhurimi (Kalimi) i Kapitalit të Shoqërisë “CIT” Sh.P.K në masën 100% të fondeve, asetëve, kuotave e titujve nga Dhuruesi tek perfituesi i dhurimit të tyre sipas përcaktimit në objektin e kësaj kontrate.

Neni 2

Mbështetur në bazën ligjore, përkatësisht neneve 761 te codit civil, neni 73 të ligjit Nr. 9901 datë 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” administratori dhe përfaqshuesi juridik i shoqërise, te hartojnë e pergatisin dokumentacionin e duhur ligjor për transferimin e Kapitalit tërësor të Shoqërisë “CIT” Sh.P.K nga dhuruesi tek perfituesi i dhurimit sipas objektit të kontratës.

Neni 3

Dokumentat ligjore për dhurimin e kapitalit nga dhuruesi tek perfituesi i dhurimit siaps neni 43 të ligjit Nr.9723 datë 03/05/2007 të depozitohen e regjistrohen në “Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” të shoqërive tregtare.

Neni 4

Kjo kontratë dhe dokumentat e tjera për dhurimin e pronësisë sipas objektit hyn në fuqi menjëherë pas regjistrimit dhe depozitimit të tyre në Q.K.R.

Neni 5

Për çështjet që mundet të mos jenë parashikuar ose që mund të kërkojnë interpretim zbatohen dispozitat ligjore të legjislacionit shqiptar në fuqi.

Mosmarrëveshjet zgjidhen me bisedime dhe/ose në rrugë ligjore në organet gjyqësore kompetente shqiptare.

Neni 6


Kjo kontratë hartohet për efekt dokumenti në 4(katër) ekzemplarë të njëjtë në gjuhën shqipe nga të cilët një depozitohet në Q.K.R, një i jepet përfituesit të transferimit të kuotave dhe dy i mbeten transferuesit të tyre.

Dhuruesi

“T.A.L.M.” Group Sh.P.K

Hamad Ben Abdennabi

Administrator



Përfituesi i dhurimit

Ganem Bin Saad Maged Al Saad El Kuwari

Me prokurë të posaçme

Hamad Ben Abdennabi